



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 60

Prishtinë, më 23 mars 2010, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE**

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Teuta Hadri, Qamile Morina, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylja dhe Vezira Emrush.

Munguan: Flora Brovina dhe Bujar Bukoshi.

I ftuar: Naser Ramadani – drejtor i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik.

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore, Nora Sahatçiu dhe Lulzim Çela - UNDP, Nexhat Shatri – Zyra e Presidentit.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 16. 03. 2010;**
- 3. Informatë nga drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik lidhur me programin kombëtar të imunizimit të obliguar për popullatën e Kosovës për vitin 2010;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 16. 03. 2010 të 16. 03. 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

3. Informatë nga drejtori i Institutit Kombëtarë të Shëndetit Publik lidhur me programin kombëtar të imunizimit të obliguar për popullatën e Kosovës për vitin 2010

Sadik Idriz – E falënderoj drejtorin e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, Naser Ramadanin, që i është përgjigjur ftesës për t'i njoftuar anëtarët e Komisionit për programin e zgjeruar të imunizimit të obliguar për popullatën e Kosovës për vitin 2010. Fillimisht fjalën e ka Naser Ramadani, pas tij edhe anëtarët e Komisionit mund të shtrojnë pyetje.

Naser Ramadani – Do t'ju njoftoj dhe t'jua sqaroj procedurat e imunizimit në Republikën e Kosovës. E falënderoj Kuvendin për lejin e procedurave të përshpejtuara për blerjen e vaksinave për imunizimin e popullatës. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik kërkesën për blerjen e vaksinave e ka bërë në Ministrinë e Shëndetësisë në mars të vitit 2009, ndërsa në shtator të vitit 2009 e kemi përsëritur edhe një herë kërkesën. Kjo vonesë ka ardhur edhe si pasojë e një marrëveshjeje të Ministrisë së Shëndetësisë me UNICEF-in, e cila ka funksionuar shumë mirë, por është ndërprerë në shtator të vitit 2009. Programi i vaksinimit për imunizim për vitin 2010 ka përfshirë porosinë e vaksinave, ruajtjen dhe transportin e tyre prej prodhuesit e deri te klienti. Gjithashtu i nënkupton zbatimin e praktikave të injektimit të sigurt, mbikëqyrjen e efekteve të padëshirueshme dhe eliminimin e drejtë të materialit të shpenzuar. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik ka për obligim ta hartojë këtë program për çdo vit, ta përcjellë situatën epidemiologjike në vend, të përgatitë raporte mujore të mbikëqyrjes së rregullt në të gjitha punktet e institucioneve shëndetësore dhe të bashkëpunojë ngushtë me zbatuesit e programit - qendrat e shëndetësisë familjare. UNICEF-i që nga viti 2001 i ka siguruar këto vakcina. Nga viti 2004 UNICEF-i dhe Ministra e Shëndetësisë kanë qenë bashkëfinancues, ndërsa sipas marrëveshjes që nga viti 2007 këto vakcina paguhen tërësisht nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë. Me vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë këtë vit në kalendarin e rregullt është futur edhe vakcina e re kundër *hemofillus influenza*. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në bazë të informatave më të reja shkencore ka vendosur që vaksinën e re ta zbatojë në kuadër të dhënies së pesë vaksinave të rregullta në kalendarin e imunizimit, që nënkupton difterinë, tetanosin, kollën e bardhë, hepatitin b dhe atë të fundit *hemofillus influenza*. Në vitin 2009 në Kosovë janë regjistruar rreth 2875 raste me sëmundje të tjera ngjithëse, të cilat mbeten të padiagnostifikuara. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik ka ndriçuar faktin se kjo pjesë e madhe e rasteve të sëmundjes së fëmijëve i përket komplikimeve që ndodhin për shkak të *hemofillus influenza* në organizmin e fëmijëve.

Deri me tani, në programin e rregullt të imunizimit, i kemi pasur të futura 9 vakcina. Tani e kemi futur edhe vaksinën e 10-të, *homofillus influenza*, që kemi vendosur të jepet si e kombinuar edhe me 4 vakcina të tjera, e quajtur *vakcina pentavaks*.

Kjo formë e dhënies së 5 vaksinave në një injeksion është një formë praktike e efikasitetit maksimal. Ne në Kosovë pas luftës nuk kemi asnjë rast të fëmijëve me sëmundjen e paralizës. E kemi barrierën e sigurt imunologjike që t'i mbrojmë fëmijët nga këto sëmundje. Programi i zgjeruar i imunizimit në Kosovë është i obliguar, ndërsa në disa shtete të Evropës është vullnetar.

Qamile Morina – Në Kuvend, me kërkesë të Qeverisë, e kemi miratuar një rekomandim për blerjen e vaksinave me një procedurë, e cila e kërkon anashkalimin e Ligjit të financave publike, sepse është kërkuar që komplet të bëhet pagesa para ardhjes së vaksinave. Në Kuvend na është mohuar diskutimi për këtë rekomandim, kështu që janë ngritur shumë dilema për këtë blerje. Qëllimi ynë nuk ka qenë assesit të jemi pengesë e një rekomandimi për furnizim me vakcina, por synimi ynë ka qenë t'i kemi disa sqarime lidhur me programin e zgjeruar të imunizimit, të cilin na e ka rekomanduar Qeveria. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik është përgjegjës për imunizimin kombëtar dhe i bën skemat sipas viti kalendarik. Në materialin tonë i kemi skemat e vaksinimit të obliguar për vitin 2009 dhe 2010, ndërsa në një tabelë tjetër përfshihet një vaksinë e re, e quajtur *pentavaks*. Sipas njoftimeve, që unë i kam, kjo vaksinë nuk përdoret në asnjë shtet të Evropës dhe nuk është e licencuar nga EMEA. Edhe arsyeshmëria ekonomike dhe praktike nuk shihet në këtë rast, sepse vetëm kjo vaksinë e re kushton afro gjysmë milioni euro. Nëse një vaksinë është e verifikuar, nuk ka rendësi se kushton edhe më shumë, por kjo është një vaksinë e paverifikuar. Janë dy lloje të kësaj vaksine – *fulli linkuit* dhe *lio*

fillajt. Nuk e dimë se cila prej këtyre llojeve do të vije te ne, sepse vaksina *lio fillajt* krijon shumë efekte anësore. Nuk e di a keni përgatitur program për realizimin e vaksinimit me këto vaksina të reja. Çështje tjetër e paqartë është doganimi i këtyre vaksinave. Nuk e kuptoj përse barnat e tjera të listës esenciale nuk doganohen, kurse këto vaksina doganohen me 10%, ashtu si parashihet në dokumentin e Qeverisë.

Teuta Hadri - Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik e ka bërë një punë të mirë në vaksinimin e fëmijëve në Kosovë. Kam një kërkesë për drejtorin e Institutit që në programin e vaksinimit të futet edhe vaksinimi me *cervariks*. Të kërkojmë përkrahje edhe nga Qeveria që të arrijmë deri të vaksinimi me *cervariks*.

Gjylnaze Sylja - Me Ligjin për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse janë të parapara edhe vaksinat e obliguara. Në Ligj thuhet që me miratimin e Ministrisë të Shëndetësisë, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik mban të drejtën e futjes së vaksinave të reja në programin e vaksinimit, varësisht nga situata epidemiologjike. Pra vaksina e re është futur, sepse situata epidemiologjike në vend po e kërkon. Nga aspekti ekonomik, vaksina e re *pentavaksi*, meqë i përmban 5 vaksina kundër 5 sëmundjeve ngjitëse, a mjafton vetëm *pentavaksi* apo duhet të jepen edhe 5 vaksinat e tjera, që janë dhënë deri tash? Ku është përparësia e këtij kombinimi, pse po shkon me këtë kombinim dhe nuk po shkon vetëm me *hemofillusi influenza*? Shuma e blerjes së vaksinave në vitin 2009 ka qenë 243,981 dollarë, ndërsa suma e blerjes së vitit 2010 është 950,879 dollarë. Përse ky ndryshim kaq i madh? Cilat janë kunderindikacionet e *pentavaksit*?

Naser Ramadani – Sa i përket çmimit më të shtrenjtë, kjo edhe ka qenë arsyeja a do ta pranojmë apo jo këtë vaksinë. Është vaksinë e re dhe kushton më shtrenjtë. *Pentavaksi* nuk ka vetëm kunderindikacione të zakonshme, që kanë qenë të pranishme edhe deri më tash. Është e pakuptueshme të mendohet të mos zbatohet programi i imunizimit për shkak të efekteve anësore të vaksinave.

Qamile Morina – Sipas njoftimeve që i kam, kërkesa për këtë vaksinë, nga viti 1999, edhe në shtetet në zhvillim ka rënë. Programi i vaksinimit në Kosovë është program i mirë. Në këtë program mund të futet edhe *hemofillus influenza*, e cila është vaksinë e licencuar, kurse *pentavaksi* është vaksinë e paverifikuar.

Rita Hajzeraj – Vaksinimi është program interesant dhe i veçantë për fëmijët tanë. Si e kuptova, rekomandimi nga OBSH-ja është se këto vaksina janë adekuate. Dëshiroj të di ku qëndron përfitimi, përderisa shtetet e Evropës nuk po e përdorin? A bëhet kjo pse është çmimi më i arsyeshëm apo për ndonjë çështje tjetër? Cilat janë shtetet që e përdorin këtë vaksinë, a shkakton efekte anësore, a ka ndonjë statistikë për pozitivitetin e kësaj vaksine në shtetet në të cilat është aplikuar?

Naser Ramadani – Fjala është vetëm për *hemofillus influenza*, jo edhe për këto vaksina të tjera, sepse ato kanë qenë në program edhe më herët. *Hemofillus Influenca* përdoret në të gjitha shtetet e Evropës.

Vezira Emrush – Kur është fjala për vaksinimin e fëmijëve, siç e kuptuam janë plani dhe programi i vaksinimit për vitin 2010. Konkretisht pyes Institutin a janë bërë analizat sa është e nevojshme vaksina *pentavaks*. A e ka marrë Instituti lejen për ta dhënë këtë vaksinë? A ekziston analiza e Institutit sa është e nevojshme kjo vaksinë në Kosovë dhe sa e përdorin vendet e rajonit?

Naser Ramadani – Në dokumentacionin tuaj ju e keni vetëm kalendarin e vaksinimit, jo edhe programin. Ekzistojnë programi dhe plani i vaksinimit. Instituti Kombëtar e harton programin e vaksinimit, ndërsa planin e vaksinimit e bën çdo komunë veç e veç. Sa i përket lejes për dhënien e vaksinës, nuk jemi të obliguar ta sigurojmë lejen, këtë e bën AKPM-ja. Analizën sa përdoret kjo vaksinë në vendet e rajonit, nuk e kemi, por mund t'ju them se kam njoftime se kjo përdoret që dy vjet në Republikën e Shqipërisë.

Nurishahe Hulaj – E vlerësoj miratimin e këtij programi të rëndësishëm për imunizimin e popullatës së Kosovës. I çmoj lart edhe kontributin, edhe punën e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik. Të gjitha vaksinat japin efekte anësore, por nuk janë këto efekte të rëndësishme në krahasim me efektet pozitive, që japin. Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik është institucion i lart referent, që e bën një punë profesionale dhe duhet ta gëzoj përkrahjen tonë në punën e tij. Është me rëndësi të vaksinohen të gjithë fëmijët. Efekte anësore mund të ketë, por me rëndësi është të parandalohet vdekshmëria e fëmijëve.

Qamile Morina – Nuk është diskutabile a duhet të vaksinohen fëmijët apo jo. Dihet se patjetër duhet të vaksinohen. Çështja është, a janë këto vaksina *pentavaks* të verifikuara apo jo? Qenësore është se a e përdor këtë vaksinë Evropa, apo jo?

Sadik Idriz – Morëm njoftime të nevojshme nga drejtori i Institutit lidhur program e zgjeruar të imunizimit. Puna e Institutit deri me tani ka qenë profesionale dhe pa asnjë eksces. Një pjesë të punës së vet duhet ta kryejë edhe AKPM-ja. Na ky takim nuk mund të nxjerrim përfundime për të gjitha problemet që ekzistojnë në shëndetësi. Sipas interesimit tuaj mund ta vizitojmë edhe Instituti Kombëtar të Shëndetit Publik.

Falënderojmë drejtorin për njoftimet që na i ofroi.

4. Të ndryshme

Vezira Emrush – Duhet të punojmë, sepse vetëm me punë mund t'i eliminojmë gabimet eventuale. Duhet të njoftohemi dhe të punojmë për shëndetin e fëmijëve tanë. Ky takim me drejtorin e Institutit ishte i rëndësishëm që ne ta kryejmë punën tonë.

Sadik Idriz – Në këtë pikë, sipas planit të punës, këtë muaj e kemi shqyrtimin e tri ligjeve, që i kemi në procedurë, por edhe kemi parapa ta ftojme ministrin e MPMS-së të na raportojë për Ligjin e punës. Sipas njoftimeve që i kemi, Ligji është kthyer prapë në Ministri, prandaj në mbledhjen e radhës do ta ftojme ministrin të na raportojë për pengesat lidhur me Ligjin e punës.

Teuta Hadri – Propozoj që për këto dy ligje, që do ti kemi në procedurë, Ligjin e punës dhe Ligjin e sigurimeve shëndetësore, ta realizojmë edhe një vizitë studimore jashtë Kosovës.

Gjylnaze Sylja – Propozoj ta angazhojmë një ekspert, i cili do ta ndihmonte Komisionin në amendamentimin e Projektligjit për produkte dhe për pajisje medicinale.

Pas diskutimeve u vendos që grupi i punës në bashkëpunim me administratën e Kuvendit ta caktojë një ekspert, i cili do të angazhohet ta ndihmojë punën e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 20

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz